



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni i Posaçëm për Reformën në Sistemin e Drejtësisë

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 23.07.2015, ora 18:00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Miratimi i projektvendimit “Për miratimin e ekspertëve, përfaqësues të Grupeve Parlamentare të opozitës”

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Eduard Halimi, Arben Ristani, Vasilika Hysi, Pandeli Majko, Spartak Braho, Oerd Bylykbashi, Gent Strazimiri, Fatmir Mediu, Vexhi Muçmata.

Mungon: Ulsi Manja

HAPET MBLEDHJA:

Fatmir Xhafaj – E hapim mbledhjen mqs kuorumi formohet. Sot në rendin e ditës kemi projektvendimin “Për miratimin e ekspertëve përfaqësues të grupeve parlamentare”.

Nesër do t’ju përcillen dokumentat e strategjisë dhe analizës.

Vasilika Hysi – Në lidhje me projektvendimin, ekspertët e propozuar do të jenë partiakë?

Oerd Bylykbashi - Nuk është hera e parë që ne bëjmë reforma. Më duket hera e parë që grupi i ekspertëve është hermetik. Kjo është një mungesë transparence totale. Unë kam qenë në krye të grupit të ekspertëve për Reformën Zgjedhore dhe çdo parti e dinte në kohë reale se kush ishin draftet, por diskutimi fillonte kur shkonte drafti final.

Eduard Halimi - Kjo metodologji nuk është transparente. Ne jemi anëtarë të Komisionit dhe duhet të hyjmë në brendi.

Gent Strazimiri - Ekspertët u bë muaj që kanë diskutuar për këtë punë, ju që keni qenë na thoni.

Fatmir Xhafaj - Dokumentin e fundit akoma nuk na e kanë sjellë. Atë që kanë punuar deri tani do ta keni nesër.

Eduard Halimi - Ne do të kontaktojmë me vetë ekspertët. Këtë gjë do ta diskutojmë me ambasadorët që të na japin materialet.

Fatmir Xhafaj – Ekspertët janë duke punuar ende. Jemi dakord me projektvendimin e paraqitur? Dakord. Miratohet. Mbledhja e radhës për të diskutuar strategjinë të mërkurën tjetër. Faleminderit

MBLEDHJA MBYLLET